VENDIM
Nr.46, datë 11.10.2010

PËR LICENCIM TË OPERATORIT PËR HERË TË PARË NDËRMARRJA E UJËSJELLËSIT SHA SHKODËR (FSHAT)

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a të nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë....." Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të licencohet operatori Ndërmarrja e Ujësjellësit sh.a. Shkodër (fshat) me:
Drejtues ligjor z. Flauers Viktor Shoshi
Drejtues teknik z. Sami Riza Grumira
2. Operatori Ndërmarrja e Ujësjellësit sh.a. Shkodër (fshat) autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është komuna Velipojë, Berdicë, Ana e Malit, Hajmel, Rrethina Postribë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datën 11.10.2014.

KRYETARI
Avni Dervishi